

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, ZNJ. RILINDA SELIMI

12/14/2020

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore, në datën 10.12.2020 për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, në datën 14.12.2020, vendosi:

Konfirmimin në detyrë subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Pamela Qirko, z. Lulzim Hamitaj relator, z. Olsi Komici anëtar, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit